

LIGJ
Nr. 27/2014

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT SHITESË 3 TË MARRËVESHJES PËR AMENDIMIN DHE ADERIMIN NË MARRËVESHJEN E TREGTISË SË LIRË TË EUROPËS QENDRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokoll i shtesë 3 i marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Europës Qendrore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.3.2014

Shpallur me dekretin nr. 8533, datë 3.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

PROTOKOLL SHITESË 3
I MARRËVESHJES PËR NDRYSHIMIN DHE ADERIMIN NË MARRËVESHJEN E TREGTISË SË LIRË PËR EUROPËN QENDRORE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Bosnja dhe Hercegovina (më poshtë të quajtura “Palët”);

Duke pasur parasysh marrëveshjen për ndryshimet dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë për Europën Qendrore, të nënshkruar në Bukuresht, më 19 dhjetor (më poshtë e quajtur “CEFTA 2006”) dhe shkëmbimin e letrave të ministrit të Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhëniet Ekonomike të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Në aneksin 3 të nenit 10, paragrafi 1 i CEFTA 2006:

Aneksi 3.1 Tabela I: kolona e katërt (Bosnja dhe Hercegovina) fshihet.

Aneksi 3.2 Tabela I: kolona e tretë (Shqipëria) fshihet.

Palët heqin të gjitha detyrimet doganore për importet, të gjitha tarifatat që kanë një efekt të barasvlershëm dhe të gjitha detyrimet e importit të një natyre fiskale ndërmjet tyre nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokoll i shtesë.

Neni 2

1. Ky protokoll shtesë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit në pajtim me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen te depozituesi.

2. Ky protokoll shtesë hyn në fuqi në ditën e tridhjetë nga depozitimi i instrumentit të fundit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

3. Kërkesat kushtetuese lejojnë që secila palë të zbatojë përkohësisht këtë protokoll shtesë. Zbatimi i përkohshëm i këtij protokoll i shtesë, në pajtim me këtë paragraf, i njoftohet depozituesit.

Në dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit e poshtëshënuar, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll shtesë.

Bërë në Bruksel/Sarajevë_____, në një kopje të vetme autentike në gjuhën angleze, e cila depozitohet te depozituesi i marrëveshjes së tregtisë së lirë për Europën Qendrore, e cila u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha palëve.